



FORÇA JONË

* * * Viti III • Nr. 22 • Mars 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin e NATO-s, Bruce Clingan

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, më 4 mars, pritën në ambientet e ministrisë komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të NATO-s, admiralin Bruce W. Clingan.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, e informoi admiralin Clingan për zhvillimet e fundit, gjithashtu edhe për vendimin e Qeverisë

për të ardhmen e FSK-së. Ai theksoi faktin se këto zhvillime të reja janë në interes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Ministri Çeku e siguroi admiralin Clingan se FSK-ja do të vazhdojë t'ju shërbejë të gjithë qytetarëve të saj, si një forcë për të mirë në rajon, e cila do të zhvillohet sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Nga ana e tij admiral Clingan përgëzoi ministrin e FSK-së për

të gjitha të arriturat dhe për punën e mirë në mbështetjen e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Ministri Çeku e falënderoi admiralin Clingan për mbështetjen që NATO-ja i ka dhënë MFSK-së dhe FSK-së përmes Ekipit Ndërlidhës Këshillues, si dhe për punën e shkëlqyer të KFOR-it si një forcë stabilizuese në Kosovë, Ai njëherësh kërkoi nga komandanti i Komandës së



Forcave të Bashkuara të NATO-s që të vazhdojë ta mbështetë Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kontraadmirali Odd Werin, shefi i delegacionit të Suedisë në NATO, vizitoi ministrinë për FSK

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, më 25 mars, pritën në ambientet e Ministrisë shefin e delegacionit të Suedisë në NATO, kundëradmiralin Odd Werin me bashkëpunëtorë.

Ministri Çeku falënderoi admiralin Werin për bashkëpunimin e shkëlqyer që MFSK-ja ka me shtetin e Suedisë, për shërbimin e kontingjentit të Forcave të Armatosura të Suedisë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, për mbështetjen e pakursyer të këshilltarëve suedez në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT) për ministrinë e FSK-së, pastaj, në fushën e bashkëpunimit ushtarako-civil, në fushën e drejtave të njeriut, në fushën humanitare (demonim) dhe në fusha tjera.

(vijon në faqen e 7)

Shefi i Shtabit të FARSH-së, gjenerali Bazo vizitoi MFSK-në

Bashkëpunim i ngushtë në mes Ushtrisë së Shqipërisë dhe FSK-së

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Kadri Kastrati, priti më 18 mars, në ambientet e Ministrisë shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura (FA) të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo si dhe delegacionin e lartë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Shqiptare. Shefi i Shtabit të FA-së të Republikës së Shqipërisë u prit me nderime të larta nga Togu Ceremonial i FSK-së.



Gjeneralmajor Bazo dhe oficerët e tjerë të lartë të FA-së të Republikës së Shqipërisë zhvilluan takime të ndara me ministrin e FSK-së, z. Agim Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, dhe pastaj të dy delegacionet mbajtën takim të përbashkët.

Të dy gjeneralët, Kastrati dhe Bazo në deklaratat për shtyp folën mbi raportet shumë të mira dhe vëllezërore ndërmjet dy institucioneve, si dhe për gatishmërinë e tyre për t'i ofruar ndihmë njëra-tjetrës. Gjenerallejtnant Kadri Kastrati me këtë rast tha se kam kënaqësinë e veçantë që sot prita shefin e Shtabit të FA-së të Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për një vizitë, e cila tregon për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy forcave tona.

"Ne me gjeneralin Bazo dhe delegacionin shqiptar biseduam për vazhdimin e bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet nesh, por edhe në regjionin në kuadër të konceptit të NATO-s".

Gjithashtu e informova gjeneralin Bazo edhe për kapacitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Kosovës, ku jemi duke punuar që sa ma shpejtë t'i krijojmë këto kapacitete. Ne kemi nevojë për bashkëpunimin dhe përkrahjen e Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që edhe në të ardhmen të na ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve tona. Po ashtu biseduam edhe për projektet e përbashkëta, sepse objektivi ynë është që Forcat e Armatosura të Kosovës të jenë edhe pjesë e familjes së NATO-s. Meqenëse FA të Republikës së Shqipërisë janë anëtare të NATO-s, atëherë eksperiencia e tyre do të na shërbejë që ne ta kalojmë atë rrugë sa më shpejtë që është e mundur dhe të jemi aktiv aty.

Në fund, gjeneral Kastrati falënderoi shefin e Shtabit të FA-së të Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për

gatishmërinë e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm për ofrimin e ndihmës për ngritjen profesionale të FSK-së.

Ndërsa, gjeneralmajori Jeronim Bazo, fillimisht falënderoi komandantin dhe ministrin e FSK-së për pritjen, si edhe shprehu gatishmërinë e FA-së për ta ndihmuar FSK-në edhe në të ardhmen në të gjitha drejtimet, duke qenë se FA-të të Shqipërisë janë edhe anëtarë me të drejta të plota në NATO.

"Vetë vizita ime, rikonfirmoi që është një hap i ri i marrëdhënieve ekzistuese të shkëlqyera që ekzistojnë midis dy vendeve dhe FA të Republikës së Shqipërisë dhe

FSK-së. Unë jam shumë i gëzuar që u ndodha në këtë vizitë në një moment tepër të rëndësishëm dhe interesant, sfidues dhe frytdhënës në historinë e zhvillimit të FSK-së. Ky është një moment i rëndësishëm që hap shpresë për një rrugëtim të ri, për rritjen e kapaciteteve dhe rritjen e bashkëpunimit dy palësh me vendet si Shqipëria dhe të tjerat. Gjeneral Bazo, në fund premtoi: "Forcat tona të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Republika e Shqipërisë në përgjithësi do të angazhohen seriozisht për të dhënë një impuls të ri marrëdhënieve dypalësh, duke u përqendruar në bashkëpunimin e mirëfilltë në fushën e arsimit dhe në fushën e trajnimit ushtarak, si dhe duke ndarë përvojën tonë modeste në fushën e integritimit euroatlantik. Për fat të mirë kemi një vullnet politik për të ecur në këtë rrugë të bashkëpunimit dypalësh" tha në fund, shefi i Shtabit të FA-së të Republikës së Shqipërisë gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Në pritjen e delegacionit ushtarak

Gjeneralë të Ushtrisë së Turqisë vizituan FSK-në

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, më 21 mars, priti në Ministri një delegacion të lartë të gjeneralëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në krye me gjenerallejtnant Musa Avsaver, shef i komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë (FART).

Komandant Kastrati e njoftoi delegacionin e Forcave të Armatosura të Turqisë mbi zhvillimin e FSK-së, operacionalizimin, kapacitetet, trajnimet,



mbështetjen për komunitetin si dhe aktivitetet humanitare. Po ashtu, gjeneral Kastrati shprehu edhe falënderimin për mbështetjen dhe përkrahjen që FARKT i ka dhënë FSK-së, gjatë procesit të ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale. (vijon në faqen 2)

të FA-së të Republikës së Shqipërisë morën pjesë gjeneralët: Bashkim Jashari (inspektor gjeneral i FSK-së) Gëzim Hazrolli, (zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore) Enver Cikaqi, (komandant i KDS-së) dhe nënkolonelët: Hasan Hoxha, Rifat Sylemani dhe Agron Bajrami. Ndërsa, delegacioni i Shqipërisë përbehej nga, kolonel Arben Toska, kolonel Idriz Haxhia, kolonel Nazmi Cahani dhe kapiten Evis Tollja.

Delegacioni i Ushtrisë Shqiptare pas vizitës në Ministrinë e FSK-së vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së dhe Regjimentin e Mbrojtjes Civile, ku gjeneralmajor Bazo zhvilloi takime me stafin e lartë të KFT-së dhe të RMC-së.

Ministri Agim Çeku priti ambasadorin e ri të Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, priti ambasadorin e ri të Republikës së Shqipërisë, z. Qemal Minxhozi, i cili kohë më parë është emëruar ambasador në Republikën e Kosovës. Në pritje morën pjesë edhe zëvendësministri, Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi. Ministri Çeku, fillimisht, z. Minxhozi i uroi detyrën e re dhe më pastaj e

njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar që ka FSK-ja. Me theks të veçantë ai foli për bashkëpunimin e ngushtë në mes të dy ministrive; asaj të Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ndërsa, ambasadori i



Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Minxhozi duke falënderuar ministrin Çeku për pritjen e ngrohtë, rikonfirmoi vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në mes dy shteteve. Vizita e ambasadorit të Shqipërisë në MFSK kishte karakter njohës.

Gjeneralë të Ushtrisë së Turqisë vizituan FSK-në

(Vijon nga faqja parë)

Gjeneralletenant Musa Avsaver, shef i Komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të FART, u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit të deritanishëm me FSK-në, dhe njëkohësisht shprehu gatishmërinë për bashkëpunim edhe më të gjerë në të ardhmen në fushën e mbrojtjes. Në takimin e përbashkët të dy delegacioneve, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli bëri një prezantim për të arriturat e FSK-së, si edhe i njoftoi të pranishmit mbi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës dhe për rekomandimet që kanë dalë nga ky proces. Delegacionin e Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë e priti në takim edhe ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, zotëri Agim Çeku. Gjatë takimit, ministri Çeku i njoftoi mysafirët për procesin nëpër të cilin po kalon FSK-ja, në drejtim të krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës, si dhe përmendi një varg temash në të cilat Republika e Turqisë mund dhe ka kapacitet ta mbështes Kosovën. Gjithashtu ministri Çeku lavdëroi punën e kontingjentit turk në kuadër të KFOR-it, si dhe punën e këshilltarit ushtarak turk në ministri dhe mbështetjen e instruktorëve turq në FSK. Nga ana e tij gjeneralletenant Musa Avsaver, kryesues i delegacionit u shpreh se është i lumtur që FSK-ja po përmbyll me sukses misionin dhe se po hapet një kapitull i ri për Kosovën në fushën e mbrojtjes. Ai tha se ashtu si edhe i gjithë populli turk, edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë iu gëzohen të arritave dhe sukseseve të vendit tuaj.

Në përbërje të delegacionit të FA-së të Turqisë ishin edhe: gjeneralletenant Sezai Bostanci, nënsekretar i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, gjeneralmajor Mustafa Ozsoy, shef i Departamentit të Kundërzbulimit, Intelgjencës dhe Sigurisë, gjeneral major Gursel Ozturk, zëvendës i nënsekretarit të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, gjeneral brigade Riza Cagatay Erdogan, shef i Departamentit të Inxhinierisë, kolonel Zorlu Topaloglu nga Komanda e Kontingjentit Turk, kolonel Erdal Dodurga, këshilltar i komandantit të FSK-së dhe kolonel Hasan Aydogdu, atashë ushtarak i Republikës së Turqisë i akredituar në Kosovë.

Ndërsa në pritje të delegacionit turk nga FSK-ja ishin të pranishëm edhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Bashkim Jashari, shef i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Ilaz Derguti, komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Skender Zhitia, shef i Departamentit të Personelit dhe nënkolonel Hasan Hoxha, ushtrues detyre i shefit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK. Ministria për FSK dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë që nga 24 dhjetori i vitit 2009 e kanë të nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, e cila i ka të rregulluara të gjitha fushat e bashkëpunimit .

Thellimi i bashkëpunimit në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK), për vizitë zyrtare, më 17 mars, qëndroi një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë,

në përbërje: z. Bekim Maksuti, shef i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar (udhëheqës delegacioni), znj. Minevere Leskovica, këshilltare ligjore në

Kabinetin e Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe z. Blerim Ukalli, nga Kabineti i Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë. Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë u prit nga kolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK, znj. Krenare Sogojeva drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Petrit Ajeti zyrtar i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri . Pas takimit në mes të dy delegacioneve u nënshkrua "Plani dypalësh për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes për vitin

2014". Në emër të Ministrisë së FSK-së, planin e nënshkroi drejtori i Departamentit për Bashkëpunim, kolonel Hasan Hoxha, ndërsa në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, z. Bekim Maksuti, shef i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Me këtë plan janë paraparë shkollimi i kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, pastaj organizimi i trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së në institucione të Republikës së Maqedonisë, si dhe vizita të ndërsjella me karakter të shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy ministrive.

Në përvjetorin e 15 të intervenimit të NATO-s, në Kosovë

Ligjëratë e ministrit Çeku në Universitetin Publik "Haxhi Zeka" në Pejë

Në 15-vjetorin e fillimit të intervenimit të NATO-s kundër forcave ushtarake të Serbisë, ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, më 24 mars, para profesorëve dhe studentëve të universitetit publik "Haxhi Zeka" në Pejë, mbajti një ligjëratë me temën: "15 vjet pas intervenimit të NATO-s në Kosovë". Interesimi i studentëve dhe profesorëve për të përcjellë ligjëratën e ministrit Çeku ishte shumë i madh. Para studentëve dhe profesorëve ministri Çeku tha: Këtu para 15 vjetëve ishte kazermë ushtarake, ndërsa sot është universitet i dijes. Nga këtu është rasti i mirë që edhe një herë të falënderojmë NATO-n, për gjithë mbështetjen që i kanë dhënë dhe po i japin Kosovës. NATO-ja për ne është më shumë se sa një Aleancë Ushtarako-

Politike, ajo është simbol i lirisë, pavarësisë, sigurisë dhe mbrojtjes tonë. NATO-ja ka qenë përkrah nesh si në TMK ashtu edhe , në FSK. Ne kemi një bashkëpunim të mirë edhe me KFOR-in, ku tani me ne punojnë dy ekipe këshilluese të NATO-s. Gjithashtu, ministri Çeku i njoftoi studentët se gjatë luftës ka pasur mbi 38000 fluturime, me gjithsej 1055 aeroplanë, ndërsa vetëm gjysma e tyre kanë qenë nga (700 aeroplanë) nga SHBA-të. Ai foli edhe për mësimet e nxjerra nga fushata ajrore, e cila nuk duhet të jetë model për krizat e mundshme në të ardhmen , duke vazhduar më tej fjalimin e tij, ministri Çeku, shtoi: "Të gjithë e dinin se Millosheviqi, kishte vendosur ta zgjidhte problemin "një herë e përgjithmonë", me



luftë të ndryshonte balancën etnike në Kosovë dhe të shkatërronte UÇK-në. Këtë e dëshmoi edhe fushata ushtarake që ndërmori Serbia, siç ishte Operacioni "PATKOL".

Ndërsa, për UÇK-në, tha se u bë pjesë e zgjidhjes vetëm në fund të vitit 1998 pasi që ajo u ringjall dhe me ardhjen e misionit verifikues bashkësia ndërkombëtare e kishte situatën më të qartë në terren. Operacioni i NATO-s, ishte i suksesshëm, me sulmet ajrore nuk synohej shkatërimi i potencialit ushtarak të Millosheviqit, por dobësimi i vullnetit të tij, për t'i rezistuar presionit të bashkësisë ndërkombëtare.

Operacionet e NATO-s, kishin për qëllim shkatërimin e sistemit kundërajror, komandës, kontrollit dhe komunikimit (aeropotet, radarët, bazat raketore, mjetet e komunikimit, postat, komandat, kazemat).

Një tjetër faktor i dobësimit të Millosheviqit ishte humbja e përkrahjes së Rusisë, e që ishte një ndër faktorët që çoi Serbinë drejt kapitullimit. Në fund, studentët dhe profesorët i shtruan shumë pyetje ministrit, të cilat kryesisht kishin të bënin me zhvillimin e Kosovës, themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, zhvillimin dhe profesionalizimin e saj, etj.

Në Kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, në Prishtinë

Ministri Çeku e njoftoi stafin e lartë të MFSK-së, për vendimin e Qeverisë për krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës

Ministri i MFSK-së, Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, më 04 mars, mbajtën një takim të përbashkët me stafin e lartë të Ministrisë dhe të FSK-së, në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), ku Ministri Çeku i njoftoi të pranishmit për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Ministri Çeku, me këtë rast, i njoftoi oficerët e FSK-së dhe stafin civil të ministrisë lidhur me vendimin e Qeverisë së



Republikës së Kosovës për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, si edhe për procesin e

Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë prej të cilit kanë dalë edhe rekomandimet e aprovuara

në Këshillin e Sigurisë. Ministri i FSK-së, Agim Çeku, duke shtjelluar konceptin e ri shtoi: "Forcat e Armatosura të Kosovës do të kenë pesë mijë ushtarë aktiv dhe tre mijë rezervë. Si pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë shefi i Mbrojtjes, i cili njëkohësisht do të jetë Komandant i Forcave të Armatosura të Kosovës, kurse Komandant Suprem do të jetë Presidentja e Kosovës" tha ndër të tjera ministri Çeku. Ministri Agim Çeku, njoftoi të pranishmit me detyrat e Forcave të Armatosura të Kosovës që do të

jenë: mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, mbështetja e autoriteteve civile, mbështetja e komuniteteve, si dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare në mbështetje dhe ruajtje të paqes. Më pas në fjalën e tij ministri Çeku, në pika të shkurtra, foli për strukturën dhe misionin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Në fund të takimit ministri Çeku u përgjigj në një varg pyetjesh të parashtruara nga oficerët e FSK-së dhe nga stafi civil i MFSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati i kënaqur me trajnimin e FSK-së, për "Doktrinën për të Ardhmen"

Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, së bashku me zëvendëskomandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin dhe atasheun ushtarak të SHBA-s në Prishtinë, kolonelin James Kott, më 7 mars qëndruan për një vizitë në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes (KDS) në Ferizaj, ku u pritën nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi. Qëllimi i kësaj vizite ishte përcjellja nga afër e trajnimit për përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen", ku në hollësi për zhvillimet e këtij trajnimi i njoftuan nga gjeneral brigade Enver Cikaqi. Trajnimi është mbajtur nga data 3 mars deri më 7 mars 2014, ku morën pjesë 19 pjesëtarë të lartë nga të gjitha njësitë e FSK-së, dhe është realizuar nga ekspertët e Drejtorisë

së Doktrinës Amerikane, James Benn dhe Michael Scully, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm si pjesë e grupit punues. Trajnimi për përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen" është vlerësuar lart dhe është cilësuar si mjaft frytdhënës si nga ana e pjesëmarrësve po ashtu edhe nga ana e ligjëruesve. Kontribut të veçantë në këtë seminar ka dhënë edhe Ekipi Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s (NLAT). Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, së bashku me delegacionin e tij përcollën paraqitjen e shkurtër të mbajtur nga James Benn, zëvendësrejtori i Drejtorisë së Doktrinës Amerikane. Pjesa e parë e trajnimit u finalizua me sukses nga oficerët e FSK-së,

pjesëmarrës në këtë trajnim, të cilët ishin shumë të entuziazmuar gjatë periudhës sa kanë punuar bashkë, tha në fund të fjalës së tij përmblylëse z. James Benn. Ndërsa, komandanti FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, fillimisht falënderoi ekipin e ekspertëve amerikan, grupin punues dhe NLAT-in, për punën e përkushtuar në përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen". Gjeneral Kastrati, më tej, tha se ndjehet krenar për punën kaq voluminoze që është bërë për një kohë të shkurtër, të cilën e shëf si rezultat të ekipit amerikan. Ai kishte edhe një porosi për grupin punues të FSK-së, duke kërkuar nga ata që mësimet e nxjerra dhe obligimet që dalin nga ky seminar ti



vejnë në zbatim me sukses. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, më tej, shtoi: "Jam i sigurt se në takimin e radhës do të shohim rezultatet e para të kësaj pune të cilën e vlerësoj lartë, e që ka qenë edhe një sfidë të cilën e kemi kaluar me sukses.

Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, për ekspertët amerikan, z. James Benn dhe Michael Scully, për punën dhe kontributin e tyre gjatë këtij trajnimi ndanë mirënjohje dhe medalje.

Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes në Shqipëri

Komisioni për bashkëpunim dhe koordinim i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i përbërë nga gjeneral brigade Enver Cikaqi, Shemsi Sylja, nënkolonel Enver Dugolli dhe Petrit Ajeti, më 3 mars, qëndruan për një vizitë zyrtare pune në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes në Shqipëri, ku u pritën nga koloneli Ruzhdi Kuçi dhe stafi i lartë i KDS-së. Vizita e delegacionit të FSK-së, pati për qëllim organizimin e diskutimeve mbi vendosjen e piketave të përbashkëta, në drejtim të unifikimit të arsimimit dhe trajnimit ushtarak midis dy vendeve, si dhe mbi dhënien e asistencës nga pala shqiptare për integrimin e FSK-së në NATO. Në takimin ku mermin pjesë grupet përkatëse të punës për diskutime të përbashkëta, koloneli Kuçi, pasi që i uron mirëseardhje delegacionit të FSK-së, e njohu gjeneral

Cikaqin dhe ekipin e tij me zhvillimet e Forcave të Armatosura (FA), ecurinë dhe zhvillimet më të fundit për përmirësimin, zhvillimin dhe konsolidimin e të gjitha strukturave arsimore ushtarake, në kuadër të rishikimit dhe përmirësimit të procesit arsimor, programit të ri pilot të trajnimit të oficerëve të rinj nga Garda Kombëtare e New Jersey etj. Më pas, duke folur për qëllimin që kjo vizitë kishte, koloneli Kuçi ndër tjerash u shpreh: "Bashkëpunimet dypalëshe të nisura më herët, kryesisht në fushën e arsimimit ushtarak, nëpërmjet përfshirjes në kurset institucionale të oficerëve të Kosovës, si në KLSM, KLO, KKSHP kanë qenë tepër produktive. Kemi arritur në një shtysë të re të marrëdhënieve tona, me projekte ambicioze dhe të insitucionalizuara. Bashkëpunimi dypalësh do të konsolidohet në të gjitha fushat;



grupet e punës janë krijuar për këtë qëllim, si dhe për të krijuar projekte të reja në kuadër edhe të "Smart Defense" ka përfunduar fjalën e tij, komandanti i KDS-së, koloneli Kuçi. Nga ana e tij, gjeneral brigade Enver Cikaqi, pasi që falënderoi palën shqiptare për mikpritjen e ngrohtë, e njoftoi edhe rreth punës që po bëhet në sistemin arsimor ushtarak që po realizohet në Task-

Qendrën Trajnuese të KDS-së. Ndër të tjera ai u shpreh "Shkolla ka nxjerrë e po nxjerrë kadro shumë të përgatitur e që kanë arritur të japin rezultate pozitive në punën e tyre. Megjithatë, shkëmbimi i ideve dhe marrja e eksperiencave tuaja në të gjitha fushat përveçse rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit në sistemin e mbrojtjes së të dy vendeve do të shërbejnë më së miri edhe përmirësimit dhe funksionimit pozitiv e

sipas standardeve edhe të punës konkrete që bëhet në institucionin tonë, atë të Komandës dhe Doktrinës. Me përkrahjen, ndihmën, sugjerimet tuaja dhe konsultimet e përbashkëta do të arrijmë në një unifikim të sistemit arsimor-ushtarak midis dy vendeve tona, si edhe do të jemi krah jush në arritjen e standardeve në kuadër të synimit për integrim në NATO, vijoi gjeneral Cikaqi". Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi dhe ekipi që e shoqëronte, nëpërmjet një paraqitje të shkurtër të mbajtur nga atasheu ushtarak shqiptar i akredituar në Kosovë, koloneli Fiqiri Hoxha u njoh me historikun e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes, me draft marrëveshjen për unifikimin e arsimimit e trajnimit ushtarak, si dhe me asistencën për integrimin në NATO të FSK-së, për të cilat u bënë diskutime përkatëse.

Manifestimi Qendror i "Epopesë së UÇK-së" u mbajt në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë

E kaluara e lavdishme frymëzim për të ardhmen

Me parakalimin e kuadrateve të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, filloi manifestimi "Epopeja e UÇK-së" më 5, 6 dhe 7 mars, në nderim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Me rastin e 16-vjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, nën përkujdesjen e kryeministrit të

përkujtojmë dhe nderojmë sakrificën sublime të gjithë atyre që dhanë jetën për shtetin, për lirinë dhe për paqen. Gjithashtu, ne kujtojmë edhe sakrificën e të gjitha brezave që me idealin e tyre i dhanë jetën dhe shpirtin Pavarësisë sonë. Rruga deri këtu ishte e vështirë dhe aspak më e lehtë nuk do të jetë puna dhe angazhimi që po na pret në forcimin e vlerave demokratike deri në arrijten e që-



Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, më 5 Mars 2014, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt manifestimi qendror "Epopeja e UÇK-së" në të cilën manifestim morën pjesë: presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit të Kosovës Jakup Krasniqi, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, ambasadorë, përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, ministra, zëvendës ministra, deputet, veteranë, invalidë dhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, drejtues të institucioneve shtetërore, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës.

ltimeve tona; anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO". Më pas, presidentja Jahjaga kërkoi nga të gjithë angazhimin maksimal për ndërtimin e shtetit. Po ndajmë një fragment nga fjalimi i saj: "Sot më shumë se kurrë na duhet një dashuri më e madhe për atdheun, një respekt dhe solidaritet për njëri-tjetrin, një bashkim i forcave tona dhe tejkalim i dallimeve të thella politike për qëllimet madhore të



Kosovës. Na duhet punë dhe sakrificë më e madhe për t'u bërë ballë sfidave në përmbyshjen e synimeve tona. Synimi ynë është që vendit tonë duhet t'i krijojmë një të ardhme të qëndrueshme, një Kosovë e cila do të mbetet rëfirim suksesi i përbashkët i yni dhe i bashkësisë ndërkombëtare dhe një vlerë e shtuar për aleatët tanë strategjikë". Ndërsa, kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi tha se me luftën e

drejtë, vendosmërinë heroike dhe mbështetjen ndërkombëtare, Kosova e realizoi ëndrrën më të lartë të saj - Lirinë. Më tej, kryeministri shtoi: "Në themelet e kësaj ëndrrë qëndron mudi dhe djersa e qytetarëve tanë, e mbi të gjitha gjaku dhe sakrifica e dëshmorëve të lirisë, ku me respekt përjetë përllemi para sakrificës së tyre". Kryeministri Thaçi, tha gjithashtu: "Dëshmi e përkushtimit tonë institucional për perspektivën tonë

europatlantike jeni vetë ju, të nderuar pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Kosovës, që me profesionalizmin tuaj po bëni që të gjithë ne të jemi krenarë. Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë profesionale dhe shumetnike, do të vazhdojmë të zhvillohemi sipas standardeve dhe natyrisht në të ardhmen e afërt do të jemi edhe pjesë e NATO-s". Gjithashtu, kryeministri Thaçi, tha se në prag të gjashtëmbëdhjetë vjetorit të Epopesë së UÇK-së, është

marrë vendimi për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës dhe urimet e para ua drejtoi ushtarëve të Forcave të Armatosura të Kosovës. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, në manifestimin e 16-vjetorit të legjendës kombëtare, tha: "Ne vijmë me avancime të institucionit tonë", duke shtuar se FSK-ja po tregon në vazhdimësi, disiplinë, profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri për avancim drejt përgjegjësisë kombëtare e ndërkombëtare, duke ndihmuar vendin tonë në synimin e tij, anëtarësimin në familjen e madhe të sigurisë globale.

Fjala e komandantit të FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, me rastin e 5 Mars mbajtur në kazermën "Adem Jashari"

E nderuara presidente Jahjaga, i nderuar kryeministër Thaçi, e nderuara familje e komandantit legjendar Adem Jashari, baca Adem Demaçi, zëvendëskryeministra, ministra, ministër Çeku, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të institucioneve shoqërore, politike e ushtarake, familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të luftës për liri, të nderuar të pranishëm, Zonja dhe zotërinj,

Më tej gjeneral Kastrati tha: "Sot, në këtë përvjetor legjendash, në nderim të kësaj ngjarje të madhe emblematike janë rreshtuar para nesh kuadrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kuadrate që tregojnë përkushtimin e Kosovës që ka bërë për të ndërtuar forcat e veta ushtarake. Forcë të cilën e kishin ideuar dhe vultur me sakrificën dhe heroizmin e tyre komandantit legjendar Adem Jashari dhe bashkëluftëtarët e tij, përfundoi komandanti i FSK-së, gjeneral Kadri Kastrati.

Në emër të familjes Jashari manifestimin e përshëndeti Bekim Jashari, djali i Hamzë Jasharit i cili pasi që shprehi lavdi për të gjithë dëshmorët e rënë për liri, uroi edhe kujtimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Në fund të këtij manifestimi parakaluan kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës me intonimin e Marshit ushtarak të ekzekutuar nga Orkestra frymore e FSK-së.

kullë. Ne sot kujtojmë jehonën e pushkëve dhe këngën e trimave që po shkruanin simfoninë e qëndrës së pamposhtshme. Jehonë e cila po prekte rrënjët dhe majën e historisë së luftës për liri. Kujtojmë kullën e Jasharijeve që u bë muranë e lirisë. Të nderuar të pranishëm, në këtë 16-vjetor të legjendës kombëtare, ne vijmë me avancime të institucionit tonë, Institucion që po tregon në vazhdimësi, disiplinë, profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri për avancim drejt përgjegjësisë kombëtare e ndërkombëtare, duke ndihmuar vendin tonë në synimin e tij, anëtarësimin në familjen e madhe të sigurisë globale.

Sot në këtë përvjetor legjendar, në nderim të kësaj ngjarje të madhe emblematike janë rreshtuar para nesh kuadrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kuadrate që tregojnë përkushtimin e Kosovës, që ka bërë për të ndërtuar forcat e veta ushtarake. Forcë të cilën e kishin ideuar dhe vultur me sakrificën dhe heroizmin e tyre komandantit legjendar Adem Jashari dhe bashkëluftëtarët e tij. Ne sot kujtojmë përpjekjet dhe sakrificën shumëvjeçare për liri dhe pavarësi të vendit tonë, kujtojmë ngritjen dhe ndërgjegjësimin e vetëdijes kombëtare për organizimin dhe mobilizim në luftën tonë të shenjtë, kujtojmë shumë luftime, beteja, rënie e heroizma të luftëtarëve të UÇK-së, kujtojmë organizimin, mobilizimin dhe luftën tonë të drejtë liridashëse që u përkrah dhe mbështet nga forcat përparimtare ndërkombëtare të udhëhequra nga SHBA-të dhe aleanca më e madhe ushtarake NATO.

Të nderuar të pranishëm, FSK-ja, gjithëherë duke pasur nismë këtë kujtim, është arsimuar, profesionalizuar, zhvilluar, modernizuar dhe çdo ditë ka dëshmuar se është një partner e denjë dhe mund të punojë krah për krah me NATO-n në çdo mision. Sot rezultat i një avancimi të gjithëmbarshtëm dhe gatishmërie profesionale, FSK po ecë drejt marrjes së detyrave dhe përgjegjësisë kombëtare; FSK po ecë drejt avancimit në Forca të Armatosura të Kosovës.

Bashkëpunimi që kemi ndërtuar me NATO-n është arritje e madhe e cila vlerësohet nga të gjithë, andaj ne sot u jemi mirënjohës miqve tanë ndërkombëtarë për atë që kanë bërë dje në luftë dhe për atë që bëjnë sot në liri. Dhe në fund, të nderuar të pranishëm! Jemi me fat që dje i takuam epokës më të ndritur të kombit tonë, epokës



Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati bënë homazhe në Prekaz

Në përvjetorin e 16-të të rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, më 6 mars, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, së bashku me stafin e lartë të MFSK-FSK-së, bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, së bashku me një delegacion të Qeverisë së Kosovës, të prirë nga kryeministri i Kosovës, z. Thaçi, presidentja e Kosovës, znj. Jahjaga dhe ministrat e kabinetit qeveritar, bënë homazhe dhe vendosen kurora lulesh në nderim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.



Dërguti, si dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së. Me këtë rast, në fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, tha: "Jemi sot këtu, së bashku me udhëheqësit e FSK-së, për ta nderuar veprën heroike të komandantit legjendar Adem

Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit. Kjo është një datë e veçantë për FSK-në, sepse këtu, sa here vijmë, marrim energji të reja dhe gjejmë motive për punë dhe sukses të reja. Ky 16-vjetor, për ne, shënon edhe një arritje të

jashtëzakonshme, formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës". Delegacioni i FSK-së, më pastaj qëndroi për vizitë në Kullën e Jasharijeve, ku u pritë nga Murat Jashari, nipi i komandantit Adem Jashari.

së UÇK-së, epokës së komandantit legjendar Adem Jashari. Ne sot jemi me fat që po ndërtojmë vendin tonë drejt së ardhmes së ndritur në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë. Andaj ne sot duhet të shfrytëzojmë këtë privilegj për të punuar për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në këtë rrugëtim, frymëzimi ynë, gjithmonë ishte dhe do të jetë heroizmi legjendar i Jasharijeve, luftëtarëve të UÇK-së dhe dëshmorëve të rënë. Lavdi heroizmit legjendar të familjes Jashari, lavdi heroizmit të komandantit legjendar Adem Jashari, lavdi dëshmorëve të UÇK-së dhe martirëve të rënë.

Kontraadmiralet Odd Werin, shefi i delegacionit të Suedisë në NATO, vizitoi ministrin për FSK

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjeneral-letenant Kadri Kastrati, më 25 mars pritën në takim shefin e delegacionit të Suedisë në NATO, kundëradmiralin Odd Werin me bashkëpunëtorë.

Ministri Çeku falënderoi admiralin Werin për bashkëpunimin e shkëlqyer që MFSK-ja ka me shtetin e Suedisë, për shërbimin e kontingjentit të Forcave të Armatosura të Suedisë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, për mbështetjen e pakursyer të këshilltarëve suedez në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT) për ministrin e FSK-së, pastaj në fushën e bashkëpunimit ushtarako-civil, në fushën e drejtave të njeriut, në fushën humanitare (deminim) dhe në fusha tjera. Gjithashtu, ministri Çeku e njoftoi

kundëradmiralin Werin mbi zhvillimin e FSK-së, ndërtimin e raporteve dypalëshe me shumë vende të NATO-s dhe vende të tjera, pjesëmarrjen në ushtrime të përbashkëta rajonale, për respektin që gëzon FSK-ja tek popullata vendore, për sfidat dhe perspektivën e saj, si dhe mbi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë. Ministri Çeku u shpreh se me rastin e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë, ne kemi qenë mjaft transparent si për opinionin e brendshëm ashtu edhe për atë të jashtëm e sidomos për faktorët vendorë e ndërkombëtarë.

Nga ana e tij, kundëradmirali Odd Werin u shpreh jashtëzakonisht falënderues për transparencën e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë, për aktivitetet në të mirë

të popullatës së vendit në përgjithësi si dhe e përgëzoi për të arriturat e deritanishme të Ministrisë dhe FSK-së.

Një prezantim të hollësishëm të procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë e paraqiti këshilltarja politike e ministrit, Besa Kabashi-Ramaj, e cila e shtjelloj këtë proces që nga fillimi e deri tek miratimi i rekomandimeve në Qeveri.

Delegacioni i Suedisë dhe në veçanti admiralet Werin shfaqën interesim për procesin në tërësi, për fazat e planifikuara të zhvillimit, fondet dhe çështje tjera të lidhura me të ardhmen.

Kjo ishte vizita e parë e admiralit Odd Werin në MFSK. Ai ishte i shoqëruar nga ambasadori i Suedisë në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës, Mats Staffansson,



Henrik Nilsson, i ngarkuar me punë pranë Ambasadës së Suedisë në Kosovë, si dhe nga ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Suedisë dhe Forcave të Armatosura të Suedisë.

Ndërsa nga pala jonë në takim me delegacionin suedez, përveç ministrit Çeku dhe komandantit

Kastratit morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigadë Gëzim Hazrolli, shefi i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Faruk Geci, këshilltarja politike e ministrit, Besa Kabashi Ramaj, si dhe shefi i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Sinan Geci.

MFSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsit, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, organizuan në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), një takim me të gjitha gratë që shërbejnë në MFSK dhe FSK, ushtarake dhe shërbyese civile.

Në këtë takim morën pjesë ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjeneral-letenant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Farina, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigadë Gëzim Hazrolli, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, përfaqësuesja e organizatës joqeveritare "Rrjeti i grave" Igballe Rugova, si edhe deputetja Ganimete Musliu, anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

I pari, 8 Marsin ua uroi grave ministri i MFSK-së, Agim Çeku, i cili me këtë rast tha: "Femrat që punojnë në Ministrinë dhe Forcë janë shumë aktive, të devotshme dhe vazhdimisht kanë dhënë rezultate në punë dhe shërbim. Ministria dhe Forca kanë bërë shumë punë që të rekrutojnë sa më shumë femra dhe se ky mund është duke u shpërblyer. Ne jemi krenar që si vend po aspirojmë integrimin euroatlantik dhe i tërë zhvillimi i institucionit tonë po bëhet në përputhje me këto standarde"përfundoi ministri Çeku. Ndërsa komandanti i FSK-së, gjener-



allejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij me këtë rast u shpreh: "Ndjehem tejet krenar që jam komandant i Forcës, në të cilën shërbejnë me sukses bashkërisht meshkuj dhe femra pa dallim". Më tej gjenerali Kastrati tha se të gjitha raportet që Ai pranon si komandant tregojnë për një performancë të shkëlqyer të ushtarakeve të Forcës gjatë shërbimit. Në fund gjenerali Kastrati i siguroi ushtaraket se përherë do ta kenë vlerësimin e drejtë për punën që bëjnë në njësi si dhe do të përkujdeset për ngritjen profesionale dhe avancimin e tyre. Gjenerali major Salvatore Farina, komandanti i KFOR-it në Kosovë, foli për rolin e femrave në Forcat e Armatosura si dhe u shpreh se ndjehet i entuziazmuar me zhvillimet që i ka bërë FSK-ja duke arritur të rekrutojë dhe të trajtojë me dinjitet një numër të mirë të femrave

duke e ditur që edhe në vendet e NATO-s, rekrutimi ka filluar jo shumë vite më parë, duke përmendur shembullin e Italisë, e cila ka filluar angazhimin e femrave në ushtri që nga viti 2000. Ai me këtë rast përgëzoi ministrin Çeku dhe gjenerali Kastratin për kujdesin e treguar ndaj çështjes gjinore.

Në fund, me një fjalë tematike, takimin festiv e përmbylli Remzie Zeqiraj, oficerë për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e FSK-së. Major Zeqiraj, pasi përshëndeti gratë dhe të pranishmit të tjerë, tha se për nderë 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë organizuar këtë takim me qëllim që nëpërmjet këtij aktiviteti simbolik, ta shënojmë këtë ditë dhe, gjithashtu, të tregojmë me këtë akt se femrat në MFSK dhe FSK janë të

vlerësuar denjësisht për kontributin që japin çdo ditë.

Major Zeqiraj, më pastaj, shtoi se: "Ne femrat -vajzat dhe gratë me shërbim në Ministrinë dhe Forcë, tani më, jemi në numër të konsiderueshëm, si në uniformë po ashtu edhe si shërbyese civile, ku shërbejnë me sukses në të gjitha njësitë, manovruese dhe ato të specializuara. E them me plot bindje se femrat ushtarake, nën oficerë dhe oficerë në vazhdimësi kanë treguar motivim, përkushtim, profesionalizëm dhe disiplinë duke qenë kështu të devotshme dhe të denja për punën që bëjnë.

Ajo shtoi se "trëndafilat e kuq", që i morën nga ministri, simbolikisht ua dedikojmë të gjitha femrave që ranë për liri, pikërisht në këtë ditë para 16 vjetëve në Prekaz, në Likoshan, në Meje, Celinë e kudo në Kosovë..

Femrat që shërbejnë në institucionin tonë, shtoi major Zeqiraj, kanë dhënë kontribut edhe në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe tani në MFSK, ku mund të them lirisht se vullneti dhe angazhimi konkret i femrave ka qenë motivim dhe shtytje edhe për gjininë mashkullore. Ne me shembullin tonë, tha Ajo, kemi dëshmuar se mundemi, duam dhe duhet të jemi faktor zhvillimi i institucionit, faktor i profesionalizimit dhe faktor që do të ndikojë në afirmimin e vlerave tona të përbashkëta si institucion dhe si

shtet.

Në fund, major Zeqiraj, tha se "edhe përkundër që jemi institucion i ri, vetëm me 5 vite të plota ngritje, zhvillim dhe profesionalizim, para nesh tani është edhe një mision i ri, unë shpresoj, ashtu si deri më tani, të gjithë bashkërisht ta zhvillojmë ushtrinë dhe vendin tonë, duke mos e harruar asnjëherë misionin shtetëror e kombëtar.

Duke ua uruar 8 Marsin, major Zeqiraj premtoi për angazhimin e të gjitha grave; "Ne nuk do të ndalemi së punuari jo vetëm për të sotmen por edhe për të ardhmen e ndritur dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e atdheut tonë".

Për ta bërë këtë ditë edhe më të veçantë, në tubim ishin të pranishme edhe shumë përfaqësuese të organizatave joqeveritare të grave në Kosovë, ku znj Igballe Rugova si përfaqësuese e OJQ-së foli për historikun e Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Pas këtij aktiviteti një delegacion i femrave ushtarake dhe disa shërbyese civile të Ministrisë dhe Forcës vazhduan rrugën për në Prekaz për t'ju bërë nderime dëshmorëve të kombit, tek Kompleksi Memorial "Adem Jashari". Delegacioni i ushtarakeve vuri kurora lulesh tek vendi ku pushon komandanti legjendar si dhe vizituan familjen Jasharaj, ku u pritën nga Shqipe Jashari, Besarta Jashari, motrat e heronjve dhe bijat e tyre, nipat e mbesat.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati ka pritur në vizitë lamtumirës shefin e Shtabit të NLAT-it, kolonelin Vincenzo Matina

Komandanti i FSK-së, gjeneral-letenant Kadri Kastrati së bashku me zëvendës komandantin e KFT-së, gjeneral brigadë Gëzim Hazrollin, pritën në një takim lamtumirës, shefin e Shtabit të NLAT (KFOR) kolonel Vincenzo Matina, me rastin e përfundimit të misionit

të tij, në FSK-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral-letenant Kadri Kastrati e ka falënderuar ekipin e NLAT-it, si dhe kolonelin Vincenzo Matina për angazhimin e tij, në drejtim të ngritjes profesionale të FSK-së. Gjenerali Kastrati i ka dhënë "Mirënjohje" kolonelit Matina,

në shenjë të angazhimit të tij, për FSK-në.

Në fund, shefi i Shtabit të NLAT-it, koloneli Vincenzo Matina, ka falënderuar Gjeneral Kastratin dhe Gjeneral Hazrollin, për bashkëpunimin e deritashëm në mes ekipit të NLAT-it dhe FSK-së.



FSK-ja mban ligjërata për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i minave

Kompania e Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) edhe këtë vit, sipas planifikimit, sezonin dimëror, e shfrytëzoi me mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer, duke ligjëruar në disa nga shkollat fillore në territorin e Kosovës. Për këtë, biseduam me nënkolonel Enver Dugollin zyrtar i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, i cili na tha, se instruktorët e FSK-së, janë licencuar dhe të përgatitur profesionalisht si dhe të trajnuar për mbajtjen e ligjëratave të tilla. Nënkolonel Dugolli tregon se gjatë këtij viti, ligjëratat për vetëdijesimin nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer, janë mbajtur në shumë shkolla fillore, në fshatrat e Hanit të Elezit, Kaçanikut, Drenasit, Podujevës, Mitrovicës, etj., ndërsa ligjëratat i kanë përcjellë mbi 2000 nxënës. Nxënësit e të gjitha shkollave, ku janë mbajtur ligjëratat, ishin shumë të interesuar për të ditë më shumë, sa i përket mjeteve të

pashpërthyer" tregon nënkolonel Dugolli. Shumë nga nxënësit dhe arsimtarët e tyre kanë shprehur falënderimet e tyre, për instruktorët e FSK-së, si dhe për kontributin që po japin oficerët e FSK-së, për ndërgjegjësimin e nxënësve me anën e këtyre ligjëratave. Nënkolonel Dugolli, ligjëratat i cilësoi shumë të rëndësishme sepse përmes tyre, fëmijët tanë po mësojnë se cilat janë mjetet e rrezikshme dhe si konkretisht duhet të veprojnë nëse hasin në mjete të tilla dhe se si, ata në të ardhmen me njohuritë e fituara në këto ligjëratat mund të kontribuojnë që të shpëtojnë një jetë. Metodot interaktive të ligjëratave që zbatohen nga ligjëruesit tanë, tregojnë për një formë të avancuar të ligjërimit dhe mësim nxënies më të shpejtë dhe të lehtë nga ana e nxënësve. Kjo formë e komunikimit me nxënës avancon raportet e ushtarakut me institucione dhe komunitet. Instruktorët e FSK-së përmes shenjave të rrezikut dhe fotografive të mjeteve të pashpërthyer po ua



sqarojnë fëmijëve në përpikëri rrezikun që ju kanoset çdo ditë. Disa nga nxënësit thanë, se FSK-ja u ka afruar atyre shumë informacione që nuk i kanë ditur më parë "Nga këto ligjëratat ne mësuam më hollësisht se sa të rrezikshme janë këto mjete, si duhet të jemi të kujdesshëm në raport me to dhe si të silllemi në rast kur i hasim ato". Ligjërimit i instruktorëve të FSK-së, për vetëdijesimin nga minat, ka filluar më 21 janar dhe ka përfunduar më 21 shkurt 2014. Kjo fushatë vetëdijesimi bëhet në bashkëpunim të Departamentit për Bashkëpunim



Ushtarako-Civil të MFSK-së, MASHT-it dhe Drejtorive Komunale të Arsimit, na njofton drejtori i CIMIC-ut, Hajrush Kurtaj. Ndërsa Ahmet Sallova, shef i Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, thotë se Ekipet e deminimit të FSK-së, gjatë vitit të kaluar, kanë pastruar mbi 113,907 metra katror, ku kanë gjetur dhe shkatërruar mbi 256 mjete të ndryshme të pashpërthyer. Gjithashtu, zoti Sallova, si një nga ngjarjet më të rëndësishme të FSK-së, thotë, se ka qenë projekti i përbashkët i FSK-së

me Ushtrinë Suedeze, në pastrimin e Parkut të Gërmisë, ku Ushtria Suedeze ka përkrahur FSK-në me makinerinë e vet të rëndë në pastrimin e rrënojave të objekteve të bombarduara në Parkun e Gërmisë. Zotëri Sallova, njoftoi se FSK-ja ka dy ekupe të EOD-së, sipas procedurave të përbashkëta të veprimit të miratuara nga KFOR dhe MFSK-ja, të cilat kujdestarojnë 24 orë 7 ditë në javë. Vetëm gjatë vitit 2013, ekipet e EOD-së, kanë pasur 85 thirrje-intervenime si dhe kanë shkatërruar 152 mjete; si mina, bomba kasetore, granata dore.

Intervistë me Roland Reshitaj pjesëtar i Kompanisë së Deminimit të FSK-së Demineri që ka pastruar shumë fusha të minuara dhe ka shkatërruar me qindra mina dhe mjete të tjera vdekjeprurëse

Roland Reshitaj në vitin 2009 inkuadrohet në Kompaninë e Deminimit të FSK-së, si ushtar i cili me sukses i ka kryer të gjitha nivelet e trajnimeve profesionale për çminimin e fushave të minuara dhe shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyer. Ai e ka fituar gradën e instruktorit për ligjërimit e mjeteve të rrezikshme, si mina dhe mjete tjera të pashpërthyer. Gjatë një vizite që i bëme Kompanisë së Deminimit u bindem me angazhimin dhe me punën profesionale të pjesëtarëve të kësaj kompanie, të cilët gjatë sezonit të verës, kanë arrit të pastrojnë mijëra metra katror të fushave të minuara, si dhe kanë shkatërruar qindra mjete të pashpërthyer, të rrezikshme për qytetarët e Kosovës. Nga këto mjete kanë humbur jetën mbi 400 qytetarë të pafajshëm dhe shumë të tjerë kanë mbetur me pasoja për tërë jetën. Tani pjesëtarët e kësaj kompanie janë angazhuar për vetëdijesimin e nxënësve nëpër shumë shkolla, për rrezikun që sjellin minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer. Komandanti i Kompanisë, kapiten Sejdi Krasniqi, me të kuptuar qëllimin e vizitës sonë, na sugjeroi që të bisedojmë me ushtarin e dalluar Roland Reshitaj. "Rolandi është shumë modest, të gjitha të arriturat e kompanisë ia dedikon shokëve të tij. Ai është nga Komuna e Suharekës, dhe në FSK ka filluar punën si ushtar në vitin 2009, në Kompaninë e Deminimit në Prizren" tha kapiteni i tij. Roland Reshitaj ka përfunduar me sukses trajnimin për BAC, DEMINIM dhe EOD, niveli 1 dhe 2, ndërsa gjatë kryerjes së trajnimeve ishte shpallur kadeti më i mirë i

gjeneratës së tij. Ai ka arrit që me sukses t'i kryej trajnimet profesionale, ku e merr titullin e instruktorit për ligjërimit për vetëdijesimin nga mjetet e pashpërthyer, gjithashtu, Ai, pa shprehur nga puna i kryen studimet në Universitetin AAB në Prishtinë. Pas përfundimit të trajnimit, specialisti profesional, Rolandi, u bashkohet njësitëve të Kompanisë së Deminimit që operojnë nëpër terrene ku rreziku nga këto mjete është ende i pranishëm. "Fillimisht si çdo i ri punën e deminierit e kam parë sa të rrezikshme po aq edhe humane, kjo ka qenë edhe njëra nga arsytet që përkushtimi im ndaj kësaj pune të jetë maksimal. Gjatë punës sime si deminier kam pas fatin të punoj në shumë vende nëpër Kosovë, ku po veçoj, pos tjerash, pastrimin nga mjetet e rrezikshme në lokacionin ku tash ndodhet autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë, pra rrugën afër brezit kufitar. Gjithashtu jam angazhuar në pastrimin nga mjetet e rrezikshme në fshatin Milaj-Prizren, në zonën rreth fshatit Belincë-Shtime, në zonën afër fshatit Luzhnicë-Suharekë, pastaj në pastrimin e shtratit të lumit Drin-Vërmicë, në pastrimin e sipërfaqeve të malit Koretnik, si dhe në disa vende të tjera, varësisht se ku më është caktuar detyra. Puna e një deminieri klasifikohet ndër punët më të rrezikshme në botë, për arsye se dihet një deminier merret me hulumtimin, identifikimin dhe asgjësimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyer. Në çdo herë jemi të ekspozuar ndaj rrezikut, por motivi kryesor që na mban lart moralin është



largimi apo shkatërrimi i çdo mjeti të pashpërthyer, i gjetur në fushë të rrezikshme, sepse një mjet i rrezikshëm është i barabartë me më shumë se një jetë njeriu, vazhdon rrëfimin e tij ushtar Reshitaj. "Nuk ka ndjenjë më të mirë se kur një fushë të rrezikshme nga mjetet plasëse, ne, e pastrojmë dhe aty rikthehet loja e fëmijëve. Ju them me plot bindje se as shkrimtari më i mirë nuk do të kishte fjalë që ta përshkruante at ndjenjë që na kaplon pas kryerjes me sukses të çminimit. Pas çdo dite kur unë e përfundoj punën, së pari e falënderoj Zotin për çdo gjë që ka shkruar mirë, falënderoj kolegët e mi që për mua janë familja ime e dytë. Mund të them me bindje se jam me fat që në Kompaninë e Deminimit kam shumë kolegë me përvojë të madhe në këtë fushë, pra që nga koha e TMK-së, të cilët më kanë ndihmuar shumë në aftësimin tim profesional, duke pasur parasysh që puna jonë përveç edukimit teorik ka të bëjë shumë edhe me

përvojën në praktikë, sepse jo çdo herë mjetet e rrezikshme gjenden ashtu siç ne i kemi mësuar, pra çdo ditë mund të përballlemi me situata të paimagjinueshme. Profesionalizmi i gjithë personelit të Kompanisë së Deminimit, është edhe një fakt i rëndësishëm për ne, sepse falë këtij profesionalizmi, prej vitit 2000 e deri më tani, kemi pastruar afër 100 000 000 m² dhe kemi asgjësuar më shumë se 83 000 mjete eksplozive plasëse dhe fatmirësisht nuk ka pësuar asnjë deminier, qoftë edhe me ndonjë lëndim të lehtë. "Fillimisht kam pasur emocione të përziera, gjatë deminimit-shkatërrimit të bombës së parë, që ka qenë një kasetë bombë BLU 97. E para; ishte një moment i rëndësishëm për mua, e dyta ishte dëshira ime ta kaloj me sukses këtë sfidë, për të cilën edhe isha trajnuar, dhe dëshira më e madhe e imja ishte t'i eliminoja të gjitha bombat e mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, të cilat kishin vrarë dhe plagosur qindra qytetarë, në mesin e tyre; fëmijë, gra dhe pleq. Në fillim e kisha pak më të vështirë, tani kjo është shumë e lehtë, jo vetëm për mua por për tërë ekipin, sepse tani jemi të përgatitur profesionalisht. Ai edhe tani kujton momentin e çminimit të parë "Kur mbërrita te numërimi: 3,2,1, ZJARR, shtypa butonin e eksplozorit dhe menjëherë u dëgjua një shpërthim i madh...". Një ndjenjë lehtësie ma përshkroi trupin, ishte fillimi i një karriere e cila besoj që do të më përcjellë gjatë gjithë jetës, e cila dita-ditës më bënë shumë krenar", na tregoi me krenari ushtari Reshitaj. Gjatë periudhës të sezonit-dimëror,

kur njësitet i ndërpresin operacionet për shkaqë të kushteve atmosferike, ne së bashku me instruktorët e tjerë të Kompanisë së Deminimit vazhdojmë me ligjëratat nëpër shkolla fillore dhe të mesme, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për rrezikun që sjellin minat dhe mjetet tjera plasëse, si dhe për mënyrën e sjelljes së tyre në praktikë. Kryesisht, sipas këtij plani, prioritet u japim atyre shkollave të cilat ndodhen në zonat ku kanë mbetur ende mjete eksplozive të pashpërthyer, por edhe në shkollat e tjera anembanë Kosovës. Gjatë orëve mësimore, që ne i mbajmë me nxënës, ne mendohe mi që atyre t'u mësojmë t'i identifikojnë (njohin) mjetet e rrezikshme, t'u mësojmë procedurat e veprimit, që në asnjë mënyrë mos t'i i prekin dhe të veprojnë sipas procedurave që i mësojnë dhe që duhet t'i ndjekin, në rast se hasin në ndonjë mjet të pashpërthyer. Gjatë ligjërimit aplikojmë edhe metodën e bashkëbisedimit me nxënës. Nga pyetjet që ata parashirojnë, shohim se interesimi i tyre që të pajisen me njohuri është mjaft i madh. Ushtar Reshitaj ka një mesazh për qytetarët e Kosovës: "Ne jemi çdo herë në shërbimin tuaj, në mënyrë që t'ju ofrojmë një jetë më të sigurt, andaj ju bëjë thirrje që çdo mjet të dyshimtë që hasin, MOS E PREKIN, por menjëherë lajmëroni Policinë e Kosovës, FSK-në apo KFOR-in. Unë uroj që kurrë askujt mos t'i ndodhë ndonjë e keqe nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer"

Kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, realizojnë ushtrimin fushor të koduar "Marsi 2014"

Bazuar në planin kalendarik të trajnimeve njësitë e KDS-së janë duke realizuar trajnime të ndryshme në bazë të planit të punës. Kështu, njëra nga njësitë e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Qendra e Studimeve Universitare (QSU), ka realizuar ushtrimin fushor të koduar "Marsi 2014".



kolonel Irfete Spahiu, e cila me këtë rast i përgëzoi kadetët për angazhimin e tyre dhe stafin e QSU-së, për një përgatitje të nivelit të lartë, ku ndër të tjera theksoi, se: "me një angazhim të tillë ju do të jeni të gatshëm që t'i realizoni detyrat të cilat dalin nga misioni i njësisë, ku ju, do të shërbëni, gjithashtu, ky përkushtim i juaji besoj se do të jetë edhe në të ardhmen si pikë referimi për zhvillimin e karrierës".

Ndërsa, komandanti i QSU-së, kapiten Avni Kiqina ka ndjek nga afër realizimin e ushtrimit fushor, ku bashkërisht me stafin e QSU-së, ka dhënë vlerësimin final për angazhimin e kadetëve, për të theksuar se përveç pjesës teorike të cilën kadetët janë duke e realizuar në hapësirën e QSU-së, po e kompletojmë edhe pjesën praktike e që ka qenë shumë e nevojshme për kadetët tanë".

Kadetët e QSU-së, pjesën teorike e realizuan në hapësirat e Kazermës "Skënderbeu" realizuar nga instruktorët e KDS-së, prej datës 14-16 mars 2014. Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë 6 pjesëtarë të stafit të QSU-së dhe 34 kadetë të cilët janë ndarë në dy grupe. Meqenëse të gjithë ishin kadetë në ushtrim, stafi i QSU-së, ka ndarë detyrat për kadetët në bazë të përvojës së gjeneratave, kjo për shkak se pjesëmarrës ishin kadetë që nga viti i parë e deri te viti i katërt. Ndërsa, stafi i QSU-së ka vëzhguar trajnimin nga afër dhe ka analizuar me kujdes punën e tyre dhe realizimin e

folotajm



FSK-ja ndërtoi urë afër Manastirit të Deçanit

Batalioni i Xhenios të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), ka përfunduar punimet e ndërtimit të urës- montazh, në Deçan, (afër Manastirit të Deçanit). Ky është projekti i dytë i këtij lloji, që FSK-ja po e realizon, për nevojat e Manastirit të Deçanit. FSK-ja, në realizimin e këtij projekti është angazhuar, me kërkesë të Manastirit të Deçanit. Batalioni i Xhenios punimet i ka filluar më 12 mars dhe i ka kryer më 19 mars 2014, ndërsa, financimin e ka bërë Ambasada e Gjermanisë, në Kosovë.

Ushtrimin Fushor, pas të cilit është bërë edhe një analizë, ku janë dhënë rekomandime për përmirësimin e disa elementeve.

Vlen të ceket se kadetët gjatë periudhës 4 vjeçare realizojnë disa ushtrime fushore, mirëpo kadetët e vitit të parë janë ata që kanë nevojë më së shumti të familjarizohen me rolin dhe detyrat që

duhet t'i kenë në terren si dhe me sfidat me të cilat duhet të ballafaqohen.

Vlerësimi final ishte se ky ushtrim ka qenë mjaft frytdhënës dhe ka ndihmuar kadetët që të shohin sfidat me të cilat mund të ballafaqohen gjatë karrierës së tyre ushtarake, dhe vendimet të cilat duhet t'i marrin.

Certifikohen edhe pjesëtarët e kursit "Reaguesit e Parë në Fushëbetejë"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj u organizua ceremonia e certifikimit të kadetëve, pas përfundimit të kursit bazik "Reaguesit e Parë në Fushëbetejë", Kursi zgjati dy javë dhe u ndoq nga 9 kadetë të FSK-së.

Ky kurs kishte një rëndësi të veçantë për pjesëtarët e FSK-së të cilët morën njohuri bazike, si në aspektin teorik po ashtu edhe atë praktik, për reagimin e parë në fushëbetejë, tha komandanti i QSS-së, major Feriz Treshnjeva.

Ndërsa, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, në fjalën e saj ndër të tjera tha: "Angazhimi i kadetëve gjatë trajnimit ka qenë në nivelin më të lartë profesional, kjo më gëzon, dhe ndjem krenare për punën dhe angazhimin tuaj që keni treguar gjatë këtij trajnimi. Unë i



përçolla me vëmendje kadetët, gjatë demonstrimit të pjesës praktike, dhe pashë se kursi ishte shumë sfidues, mirëpo angazhimi i kadetëve dhe instruktorëve kanë bërë që kursi "Reaguesit e Parë në Fushëbetejë" të jetë më i përbalueshëm dhe më i lehtë në përbalimin e barrierave që dalin përpara".

Gjithashtu edhe përfaqësuesi i

Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s (NLAT) major Giorgio Ecclesie, tha: "Ndjem mirë që jam para jush në emër të NLAT-it, ku kam kënaqësinë të ndaj bashkë me ju krenarinë dhe bashkëpunimin. Ky kurs që ju po përfundoni sot, është një nga trajnimet i cili gjatë periudhave sa kam marrë pjesë nëpër misione jashtë vendit, sidomos në

Afganistan, na është nevojitur më së shumti. Reaguesit e parë janë ata të cilët u japin ndihmë pjesëtarëve në fushëbetejë të parët, dhe është një punë e cila donë përkushtim për të arritur rezultate, mirëpo unë kam parë, se ju e keni edhe përkushtimin, edhe vullnetin dhe për këtë më së miri flasin rezultatet tuaja, për çka ju përgëzoj dhe ju uroj suksese".

Kursi "Reaguesit e parë në fushëbetejë", fillimisht, është realizuar nga instruktorët e Ushtrisë Amerikane, të cilët i kanë përgatitë instruktorët e FSK-së, ndërsa, tani këto trajnime po i kryejnë me sukses instruktorët e KDS-së, të cilët po e realizojnë kursin me temat e njëjta dhe po përgatisin pjesëtarët e FSK-së se si duhet reaguar në situata të tilla.

Në fund, Major Treshnjeva, kërkoi nga kadetët që njohuritë e fituara gjatë trajnimit t'i bartin nëpër

njësitë e tyre, ndërsa kjo është edhe një mundësi e mirë që trajnimet po standardizohen në të gjitha njësitë e FSK-së. Disa nga temat kryesore të cilat janë ligjërues gjatë këtij trajnimi janë: kryerja e kujdesit taktik luftarak, kontrollimi i gjakderdhjes, hapja dhe menaxhimi i kanaleve të frymëmarrjes, trajtimi i plagëve shpues të krahavorit, inicimi i kartelës mjekësore të terrenit, kërkesa për evakuim mjekësor dhe zhvendosja taktike e viktimës, etj.

Vlen të ceket se trajnimi është realizuar në formë të kombinuar teori dhe praktikë, ku pjesëtarët patën rastin të demonstrojnë se si duhet reaguar në fushëbetejë dhe njohuritë e marra në teori t'i aplikojnë edhe në praktikë.

Në fund, kolonel Irfete Spahiu, major Giorgio Ecclesie dhe major Feriz Treshnjeva, për pjesëmarrësit e kursit ndanë certifikata.

Certifikohen pjesëtarët e kursit "Procedura e Udhëheqjes së Trupave"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve, pas përfundimit të kursit "Procedura e Udhëheqjes së Trupave" (PUT). Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, përfaqësuesi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s, (NLAT) kolonel Dean Kranjcec, si dhe oficerë tjerë të KDS-së dhe ekipit të NLAT-it.

Me këtë rast, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, u shpreh se ndjehet i lumtur që ky

kurs ka dhënë rezultate të larta dhe është cilësuar mjaft frytdhënës, si nga ana e pjesëmarrësve ashtu edhe nga ana e instruktorëve. Për këtë flasin më së miri edhe rezultatet e arritura në testin final.

Gjeneral Cikaqi i porositi kadetët, që njohuritë e fituara këtu t'i bartin me sukses tek njësitë e juaja, sepse ky kurs e arrin efektin e tij vetëm atëherë kur pjesëtarët e njësisë tuaja t'i mësojnë këto procedura dhe t'i standardizojnë në nivel të FSK-së.

Ndërsa, komandanti i Qendrës së Stërvitjes Kolektive (QSK), major Naim Sylejmani, foli për rolin dhe rëndësinë e kursit, nevojën për të

mësuar se si duhet udhëhequr me trupat, si dhe për angazhimin e pjesëtarëve dhe të instruktorëve të cilët me angazhimin e tyre maksimal bënë që të arrihen këto rezultate të larta.

Kjo është gjenerata e parë për vitin 2014 që po e realizon Qendra e Stërvitjes Kolektive, në kuadër të planit kalendarik të trajnimeve. Në këtë trajnim morën pjesë 16 pjesëtarë të njësisë të ndryshme të FSK-së. Kursi është realizuar nga data 18 shkurt deri më 11 mars 2014. Kursin e kanë ndjekur pjesëtarët e nivelit komandant skuadre deri tek niveli komandant kompanie, me grada kapter deri te grada kapiten.

Temat kryesore të cilat janë mësuar gjatë trajnimit janë: lidhshipi, taktikat, trillet e betejave, procedurat e udhëheqjes së trupave, simbolet dhe grafiket taktike, planet dhe urdhrat, ndërtimi i maketit, sistemi i informacionit gjeografik (GIS), ushtrimi në harta, etj.

Vlen të ceket se trajnimi është realizuar në formë të kombinuar teori-praktikë, ku kadetët patën rastin që për secilën temë njohuritë e marra në teori t'i demonstrojnë edhe në praktikë, në maketin e punuar nga QSK-ja, si dhe duke praktikuar ushtrime në harta.

Në fund për të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit u ndanë certifikata



dhe mirënjohje nga komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, zëvendës komandanti, kolonel Spahiu dhe përfaqësuesi i NLAT-it, koloneli Dean Kranjcec.